



**Republika e Kosovës – Republika Kosova– Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština – Assembly**

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 20
SHKURT 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
20. FEBRUARA 2008. GODINE**

**Shkurt – Februar
2008**

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 20 SHKURT 2008

Seanca filloi punën në orën 10,00.

Seancën e kryesoi zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar ministra,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në seancën sotme plenare të Kuvendit të Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 100 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë të datës

15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2008 për seancën plenare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, së bashku me materialin, iu janë shpërndarë deputetëve.

Propozoj që të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Raportit të Komisionit ad-hoc lidhur me shqyrtimin e projektligjeve nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës**

Miratimi, në parim, i projektligjeve është bërë më 19 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tyre, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar projektligjet dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.
Ftoj zotin Fehmi Mujota që në emër të Komisionit ad-hoc t'i arsyetojë rekomandimet.

FEHMI MUJOTA: Zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
Kolegë deputetë dhe deputete,

Komisioni ad-hoc, mbi bazën e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 19 shkurt 2008, është mbledhur dhe me punën intensive, për kohën sa e ka pasur në dispozicion, ka bërë shqyrtimin e të gjitha projektligjeve të cilat janë aprovuar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës.

Që në fillim do t'ju informoj se në Ligjin e parë, që ka të bëjë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, ka një lloj pajtimi në mes të sponzoruesve që Ligji të tërhiqet nga diskutimi, meqë draftligji i diskutuar në shqyrtimin e parë ka qenë një draftligj që nuk i përshtatet draftligjit të fundit, prandaj ne si Komision ad-hoc kërkojmë mirëkuptim që edhe amendamenti i paraqitur për këtë ligj, të tërhiqet.

Prandaj, ky projektligj, domethënë Projektligji numër 1 tërhiqet nga shqyrtimi i dytë, në leximin e dytë dhe sigurisht se ky do të vijë në një mbledhje të ardhshme me pakon e ligjeve të tjera që do të shqyrtohen.

Më lejoni që ta informoj Kuvendin se, mbi bazën e mandatit që ka marrë Komisioni ad-hoc nga ky Kuvend, puna ka qenë jashtëzakonisht intensive, përpjekjet kanë qenë të mëdha të Komisionit ad-hoc që të bëjë përputhshmërinë e ligjit, ashtu sikur e kemi të paraparë edhe në mandatin tonë. Me siguri, të gjithë anëtarët e Komisionit kanë pasur amendamente të tyre dhe përpjekjet e tyre për të ndryshuar çështjet të cilat do të rregullonin më mirë jetën e qytetarëve të Kosovës.

Ju keni para veti dhe po shihni se kemi të bëjmë me një numër të amendamenteve të cilat rregullojnë kryesisht çështje të natyrës teknike dhe çështje të cilat fillimisht nuk kanë qenë të rregulluara për shkak se ligjet kanë qenë të hartuara në një kohë pak më të hershme, prandaj shohim se mbi bazën e Dokumentit gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit – ligjet janë në përputhshmëri të plotë, pothuaj se, me ato që janë aprovuar në këtë Kuvend dhe lusim Kuvendin që të ketë mirëkuptimin dhe t'i aprovojë ndryshimet e parapara përmes amendamenteve që i ka ofruar Komisioni, varësisht prej ligjit të cilin e ka shqyrtuar.

Prandaj, më lejoni që të them se gjatë shqyrtimit tonë kemi hasur në shumë vështirësi për të ardhur deri te shpjegimet adekuate për çështje të caktuara, për emërtime, për shprehje dhe për çështje që kanë të bëjnë me rregullimin e jetës së njerëzve në Kosovë.

Të vetëdijshëm se shumë çështje, të cilat nuk janë të natyrshme me jetën e qytetarit të Kosovës dhe do të kërkojnë rregullim të ri ose rregullim përmbajtjesor, cilësor në të ardhmen, mendojmë si Komision ad-hoc se këto çështje mund të rregullohen në formë të ligjeve të reja në kohën kur Kosova do ta përshtatë jetën e vet, për qytetarët e vet, në mënyrë çfarë atyre iu përgjigjen.

Prandaj, ligjet, të cilat tani po i trajtojmë dhe amendamentet që ju i keni para vetes, janë në përshtatje me propozimin gjithëpërfshirës të Pakos së Marti Ahtisarit dhe me nevojat momentale për ndryshimet të cilat ne i kemi paraparë.

Lus Kuvendin që për të gjitha këto amendamente të ketë mirëkuptim dhe t'i aprovojë, në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Mujota!

Ju njoftoj me përmbajtjen e pikave 4 dhe 5 të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Pika 4. Ndryshimet e propozuara dhe të aprovuara nga Komisioni ad-hoc, formalisht do të aprovohen nga Kuvendi pas kërkesës së përkrahur nga shumica e anëtarëve të Kuvendit.

Asnjë ndryshim, përpos atyre të prezantuara nga Komisioni ad-hoc, nuk mund të merret në konsiderim nga Kuvendi.

Pas miratimit, ligjet do të hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Pika 5. Pas rishikimit nga Komisioni ad-hoc dhe vetëm sipas kërkesës, çdo grupi parlamentar do t'i lejohen 5 minuta për komente gjatë leximit të dytë.

Nëse kryetarët e grupeve parlamentare janë të përgatitur, i ftoj të marrin fjalën. Sipas radhës, fjalën e ka Ramë Buja – nga Partia Demokratike e Kosovës.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë të nderuar deputetë,

Pas një pune që është bërë në Komisionin ad-hoc dhe ndihmës që i është dhënë nga Grupi Parlamentar, ne nuk na mbetet gjë tjetër përveç se t'u japim përkrahje këtyre projektligjeve dhe, natyrisht, edhe të gjitha amendimeve që janë bërë nga Komisioni ad-hoc. Ju faleminderit!

KRYETARI: Sipas radhës, fjalën e ka Lutfi Haziri, nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit zoti Kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra,

Në emër të Grupit Parlamentar konfirmoj mbështetjen e të gjitha amendamenteve që Komisioni ad-hoc i ka punuar gjatë ditës së djeshme sipas procedurave që i kërkon mocioni.

Vetëm një sqarim. Ligji i parë për Ministrinë e Jashtme i kthehet Qeverisë në rishqyrtim të plotë, duke kaluar në procedura të domosdoshme deri sa të vjen me pjesën e pakos së dytë në Parlament. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit zoti deputet!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti Kryetar,
Zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i mbështetë amendamentet e Komisionit ad-hoc për shqyrtimin e ligjeve që burojnë nga Propozimi gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari, përkundër faktit të afatit të shkurtër kohor, të vetëdijshëm se këto projektligje kanë kaluar edhe nëpër faza të tjera të shqyrtimit të tyre dhe se shumica e tyre janë pjesë e drejtpërdrejtë e Pakos së Ahtisarit.

Me gjithë rezervat që kemi shfaqur, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re është shprehur me kohë për miratimin e këtyre ligjeve, të bindur se ligjet e tjera të pjesës së dytë do të kenë afat më të gjatë kohor për t'i shqyrtuar dhe debatuar ashtu siç e meritojnë.

Grupi Parlamentar i AKR-së i mbështetë, edhe njëherë po e përsëris, i mbështetë këto amendamente të propozuara nga Komisioni ad-hoc. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Makolli!
Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AAK-së Ardian Gjini.

ARDINA GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Ministra,
Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Edhe Grupi Parlamentarë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i mbështetë edhe amendamentet e Komisionit ad-hoc, edhe kalimin e ligjeve në lexim të dytë. Të njëjtën kohë mendojmë se tërheqja e Ligjit të parë për Ministrinë e Punëve të Jashtme ka qenë dashur të përcillet me një shpjegim prej sponzoruesit. Mendojmë se Kuvendi ka nevojë që të dëgjojë prej sponzoruesit pse po tërhiqet ligji. Përndryshe, Komisioni nuk ka vendosur mbrëmë në darkë që ligji të tërhiqet, do të thotë se është vendosur sot. Mendoj se ne e meritojmë një shpjegim të vetëm për çka ka ndodhur. Ne i kemi dhënë amendamentet dhe kemi pasur pajtim të plotë për ato amendamente në Komisionin ad-hoc. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Gjini!
Fjalën sipas radhës e ka Grupi Parlamentar i LDD-së, zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Zoti kryetar,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike Dardanisë dje ka dhënë qëndrimin e vet sa i përket pjesës së pakos të këtyre projektligjeve dhe duke qenë në dijeni dhe duke qenë të vetëdijshëm për punën të cilën është bërë gjatë procesit negociator dhe gjatë procesit nëpër të cilin ka kaluar Kosova, nuk mbetet asgjë më tutje dhe qëndrimi ynë është në përputhje me qëndrimin që kemi shprehur gjatë procesit të leximit të parë.

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar SLS, nuk është këtu.
Grupi Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Poštovani predsedniče,
Gospodo ministri, zamenici premijera,
Kolege poslanici.

I Parlamentarna grupa „7+“ prihvata predložene amandmane za usvajanje zakona u drugom čitanju, svih zakona, dakle. Međutim, zbog jučerašnje brzine, jer u narodu se kaže nekada da je brzina vražji posao, ponekad ponešto može i da promakne tako da nije neobično ako vam kažem da u Nacrtu zakona u administrativnim granicama opština koji je baziran na Ahtisarijom dokumentu, članom 12. predviđene su konsultacije sa nevećinskim zajednicama sa civiljem stvaranja novih opština. Kažem ponovo, zbog vremenskog ograničenja promaklo nam je da intervenišemo da ovaj član bude dopunjem vremenskim određenjem da budu te konsultacije završene u tranzicionom periodu od 120. dana, kako je bilo i predviđeno Ahtisarijevim predlogom. Molimo da se ova naša sugestija uvrsti u ovaj član kao dodatak članu 12.1.

KRYETARI: Faleminderit, deputeti Murati!

Para se të procedojmë, mendoj që duhet të ndryshohet emërtimi i ligjeve. Aty ku përmendet: “Kosova” duhet të thuhet: “Republika e Kosovës”. Mendoj që ky duhet të jetë një amendament për të gjitha ligjet.

Tani e lexova nenin 4, mendoj që nuk kemi çka të diskutojmë tjetër.
Procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni Ad-hoc.

1. Atëherë, fillojmë sipas raportit të Komisionit ad-hoc. Ju dëgjuat se sipas raportit, ndërkohë Komisioni ad-hoc rekomandon që Projektligji i parë për Ministrinë e Punëve të Jashtme të tërhiqet dhe kjo është bërë edhe me kërkesën e sponsoruesit.

Votojmë për këtë rekomandim.

Kush është për heqjen e Ligjit të parë për Ministrinë e Punëve të Jashtme? Votojmë me ngritjen e dorës.

Sekretaria, le t’i numërojë votat!

Kush është “kundër”?

A abstenon ndokush?

Ju njoftoj se në sallë kemi 101 deputetë.

Me 72 vota “për”, 11 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet ky rekomandim.

2. Vazhdojmë më tutje, për ligjin e dytë. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për statusin, imunitetin dhe privilegjet diplomatike konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj dhe një zëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit të Kosovës miratimin e Projektligjit, pa ndryshime.

Lus deputetët dhe regjinë le të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Me 90 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet Projektligji.

3. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Shtetësinë e Kosovës dhe njëzëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamente të propozuara në vijim:

Amendamenti 1

Po e lexoj edhe tekstin: “Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës” ky është amendamenti.

Votojmë: Lus deputetët dhe regjinë të përgatitemi për votim.

Votojmë tash:

Me 90 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti.

4. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Policinë dhe një zëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara në vijim.

Amendamenti 1

“Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për Policinë e Kosovës”.

Lus deputetët dhe regjinë, le të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Me 91 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti.

Amendamenti 2.

Në nenin 7, paragrafi 3 fjalët: ”kryetari i Kuvendit Komunal, zëvendësohen me fjalët; “kryetari i Komunës”.

Përgatitemi për votim.

Votojmë tash:

Me 92 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 2.

5. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe njëzëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentin e propozuar në vijim:

Amendamenti 1.

“Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për Inspektoratin Policor të Kosovës, miraton”.

Votojmë tash:

Me 93 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti.

6. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për dokumentet e udhëtimit dhe njëzëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara në vijim:

Amendamenti 1.

“Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për dokumentet e udhëtimit, miraton”.

Përgatitemi për votim.

Votojmë tash:

Me 92 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 1.

Amendamenti 2

Në nenin 15, pas fjalëve në gjuhën zyrtare shtohet fjala: “edhe në gjuhën zyrtare të komuniteteve” dhe vazhdon teksti i nenit,.. zyrtarët e komunave, më falni!

Votojmë tash:

Me 88 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet edhe amendamenti numër 2.

7. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës dhe njëzëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentin e propozuar në vijim:

Amendamenti 1.

“Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me qëllim të rregullimit të përdorimit të simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës, miraton”.

Përgatitemi për votim.

Votojmë tash:

Me 86 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti.

8. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për zonat e veçanta të mbrojtura dhe njëzëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara në vijim:

Amendamenti 1.

“Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për zonat e veçanta të mbrojtura, miraton”.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 9 “kundër”, dhe 11 abstenime, miratohet amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.

Në nenin 7, paragrafi 1, pika 6, emri: “Igoriqi”, zëvendësohet me emrin: “Gorioqit”.

Në paragrafin 5, pika (i), emri: “Dollaci”, zëvendësohet me emrin: “Dollci”.

Votojmë tash:

Me 74 vota “për”, 3 “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti numër 2.

9. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për vetëqeverisjen lokale dhe njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara në vijim:

Amendamenti 1.

“Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Votojmë tash:

Me 85 vota “për”, 1 “kundër”, dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti numër 1.

Amendamenti 2

Në tërë tekstin e Projektligjit, fjalët: “Kryetari i Kuvendit komunal”, zëvendësohet me fjalët: “Kryetari i komunës”.

Votojmë tash:

Me 91 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti numër 2.

Amendamenti 3

Në nenin 30, paragrafi 5, fjalët: “ka shkelje serioze e ligjit”, zëvendësohen me fjalët: “ka shkelje të ligjit”.

Votojmë tash:

Me 82 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti nr. 3

Amendamenti 4.

Në nenin 37, paragrafi 3, rikonfirmohet si vijon: “Anëtari i Kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës”.

Votojmë tash:

Me 85 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti numër 4.

10. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për kufijtë administrativ të komunave dhe njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara në vijim:

Amendamenti 1.

Fjalja e parë e preambulës formulohet si vijon: “Në bazë të dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”

Votojmë tash:

Me 85 vota “për”, 4 “kundër”, dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti numër 1.

Amendamenti 2

Në aneksin e Ligjit, faqe 36, neni 7.2: “Zonat kadastrave të Komunës së Junikut: Rastavicë, Sllup dhe Voksh barten në Zonën kadastrale të Komunës së Deçanit”.

Votojmë tash:

Me 81 vota “për”, 3 “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti numër 2.

Tani e kemi votimin për gjithë pakon, duke e hequr nga ajo Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Votojmë për këto ligje:

- Ligjin për privilegje dhe imunitete diplomatike,
- Ligjin për shtetësinë,
- Ligjin për policinë,
- Ligjin për Inspektoratin policor.
- Ligjin për dokumentet e udhëtimit,
- Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore,
- Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura,
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale, dhe
- Ligjin për kufijtë administrativ të komunave

Lus deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Me 77 vota “për”, 4 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet pakoja prej 9 ligjesh.

Me këtë votim, seanca e sotshme përfundoi punimet.

Mirupafshim, në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës